



Crna Gora / Mali i Zi
OPŠTINA ULCINJ
KOMUNA E ULQINIT
Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj
Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik
Br. / Nr. 08-082/24-1293/1
Ulcinj / Ulqin, 14.10.2024. god.vit

**PROGRAMI I SHQYRTIMIT PUBLIK
PËR PROJEKTVENDIMIN PËR KRITERET, MËNYRËN DHE PROCEDURËN E
SHPËRNDARJES SË FONDEVE PËR PROMOVIMIN E KOMUNITETIT TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK)**

Kryetari i Komunës së Ulqinit, me vendimin numër 01-040/24-1384/1 të datës 26.09.2024, ka konfirmuar Projekt Vendimin për kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së fondeve për promovimin e komunitetit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe përcaktoi që shqyrtimi publik për projektvendimin e lartpërmendur të zgjasë 15 ditë duke obliguar Sekretariatit për ekonomi dhe zhvillim ekonomik të realizojë shqyrtimin publik.

Shqyrtimi publik në lidhje me Projekt Vendimin për kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së fondeve për promovimin e komunitetit të TIK-ut në kohëzgjatje prej 15 ditëve do të zgjasë prej datës 16.10.2024 deri më 30.10.2024.

Vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe mendimet në formë të shkruar duhet të dorëzohen në adresën Komuna e Ulqinit – Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik përmes Zyrës së qytetarëve të Komunës së Ulqinit ose në formë elektronike në emailin ekonomi@ul-gov.me brenda afatit të përcaktuar.

Qasja në Projek Vendimin gjatë periudhës së shqyrtimit publik mund të realizohet në ambjentet e Sekretariatit për ekonomi dhe zhvillim ekonomik të Komunës së Ulqinit (Adresa: Bul. Gj. K. Skënderbeu) në zyrën numër 115 të hënën, të mërkurën dhe të premten nga ora 11:00 deri në 13:00.

Projekt Vendimi për kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së fondeve për promovimin e komunitetit të TIK-ut do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Ulqinit www.ul-gov.me.

Shqyrtimi publik qendror do të mbahet në sallën e vogël të Kuvendit të Komunës së Ulqinit me datë 28.10.2024, me fillim në ora 11:00.

Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik do t'i shqyrtojë të gjitha vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe mendimet e pjesëmarrësve në shqyrtimin publik, pas të cilit do të hartojë raportin e shqyrtimit publik.

SEKRETARIATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM EKONOMIK

